




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

PROJEKTVENDIM

Nr. 33, datë 16.11.2023



PËR

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES SË PËRDORIMIT TË
BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM
HIDROENERGJETIK, ME NR.PROT. 695/1 DATË 14.7.2017
DHËNË ME VENDIM NR.45 DATË 9.6.2017 NGA KBU SEMAN,,
SUBJEKTIT "DUKONA" SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Seman.

V E N D O S I:


1. Miratimin e rinovimit të lejes së përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik, me nr.prot. 695/1 datë 14.7.2017 dhënë me vendim nr.45 datë 9.6.2017 nga KBU Seman,, subjektit "Dukona", me vendndodhje në përroin e Dukonës, degë e lumit Osum, Bashkia Berat, Qarku Berat".

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Dukona

Vepra e marrjes 1

- $X = 508909.5$; $Y = 4512098.4$; $Z = 520$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja mesatare $Q_{mes} = 0.366$ m³/s

- 
- Prurja llogaritëse $Q_{\text{llog}} - 0.6 \text{ m}^3/\text{s}$
 - Prurja ekologjike $Q_{\text{eko}} - 0.055 \text{ m}^3/\text{s}$
 - Sasia e ujit që jepet në përdorim $Q - 0.6 \text{ m}^3/\text{s}$

Godina e Centralit

- $X = 507102.6$; $Y = 4512008$; $Z = 360 \text{ m.m.n.d. (KRGJSH)}$
- Vëllimi i rrjedhës së kthyer: $0.6 \text{ m}^3/\text{s}$

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

